

VENDIM
Nr. 44/2021

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT DHE PROPOZIMIT TË KOMISIONIT
PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT
E NJERIUT “PËR NGRITJEN E NJË KOMISIONI HETIMOR, BAZUAR
NË KËRKESËN E NJË GRUPI DEPUTETËSH, PËR SHKARKIMIN
NGA DETYRA TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 55 dhe 112, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, bazuar në kërkesën e 49 deputetëve, për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e raportit dhe propozimit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut “Për ngritjen e një komisioni hetimor, bazuar në kërkesën e një grupi deputetësh, për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 7.5.2021.